

**A - Lutjes për lëshimin ose vazhdimin e lejes unike për personin, i cili është i rivendosur brenda shoqërisë ekonomike si punëtorë udhëheqës (neni 21. dhe 23. i Ligjit për punësim, vetëpunësim dhe punë të huajve) duhet bashkëlidhur:**

- fotografinë e të huajit ose numrin referues nga deponimi elektronik i fotografive;
- pasaportën ose fotokopjen e verifikuar të pasaportës së të huajit;
- dëshminë për sigurimin shëndetësor adekuat, i cili mbulon së paku shërbimet shëndetësore emergjente në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji thekson, se në Republikën e Sllovenisë nuk posedon sigurimin e detyrueshëm shëndetësor;
- vërtetimin nga evidenca penale të shtetit amë të huajit gjithmonë në rastin e lutjes për lëshimin e lejes së parë, kurse në rastet tjera, nëse organi kështu kërkon;
- dëshminë lidhur me këtë, se subjekti mikpritës i përket shoqërisë së lidhur;
- kontratën për punësim dhe aktin e rivendosjes;
- dëshminë, se në shoqërinë e lidhur është i punësuar së paku 9 muaj, në rastin e rivendosjes së parë nga shteti, i cili nuk është anëtar i Unionit evropian;
- dëshminë lidhur me atë, se në subjektin mikpritës do të kryej punët dhe detyrat, të lidhura me udhëheqjen, organizimin ose mbikëqyrjen.

**Në procedurën e lëshimit të lejes unike njësia administrative dhe Enti i Republikës së Sllovenisë për punësim sipas detyrës zyrtare do ti sigurojnë të dhënat në vijim:**

- mbi sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji me rastin e dëshimit të sigurimit shëndetësor thekson, se në Republikën e Sllovenisë ka sigurimin e detyruar shëndetësor;
- nga evidenca penale, evidenca e aktgjykimeve të plotfuqishme përkatësisht aktvendimeve për kundërvajtjet, të cilat në Republikën e Sllovenisë i mbanë Ministria e drejtësisë;
- nga evidencat për vendimet e plotfuqishme të kundërvajtjeve, të cilat i mbajnë organet për kundërvajtje në Republikën e Sllovenisë;
- mbi aktakuzat e plotfuqishme të depozituara dhe aktgjykimet e jo plotfuqishme të lëshuara, të cilat i mbanë gjykata kompetente;
- nga evidencat, të cilat i mban organi tatimor mbi detyrimet tatimore të jopaguara të skaduara dhe mbi kundërvajtjet tatimore, të cilat janë të shënuara si sekret tatimor.

**B – Lutjes për lëshimin ose vazhdimin e lejes unike për personin, i cili është i rivendosur brenda shoqërisë ekonomike si ekspert (neni 21. dhe 23. i Ligjit për punësim, vetëpunësim dhe punë të huajve) duhet bashkëlidhur:**

- fotografinë e të huajit ose numrin referues nga deponimi elektronik i fotografive;
- pasaportën ose fotokopjen e verifikuar të pasaportës së të huajit;
- dëshminë për sigurimin shëndetësor adekuat, i cili mbulon së paku shërbimet shëndetësore emergjente në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji thekson, se në Republikën e Sllovenisë nuk posedon sigurimin e detyrueshëm shëndetësor;
- vërtetimin nga evidenca penale të shtetit amë të huajit gjithmonë në rastin e lutjes për lëshimin e lejes së parë, kurse në rastet tjera, nëse organi kështu kërkon;
- dëshminë lidhur me këtë, se subjekti mikpritës i përket shoqërisë së lidhur;
- kontratën për punësim dhe aktin e dërgimit;
- dëshminë, se në shoqërinë e lidhur është i punësuar së paku 9 muaj, në rastin e rivendosjes së parë nga shteti, i cili nuk është anëtar i Unionit evropian;

- dëshminë mbi së paku arsimim të profesionit si dhe dëshmitë mbi diturit e veçanta dhe përvojat profesionale në lëmin e zbatimit të veprimtarive të regjistruara të shoqërisë ekonomike, në të cilën i huaji është i rivendosur.

**Në procedurën e lëshimit të lejes unike njësia administrative dhe Enti i Republikës së Sllovenisë për punësim sipas detyrës zyrtare do ti sigurojnë të dhënat në vijim:**

- mbi sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji me rastin e dëshmimit të sigurimit shëndetësor thekson, se në Republikën e Sllovenisë ka sigurimin e detyruar shëndetësor;
- nga evidenca penale, evidenca e aktgjyqimeve të plotfuqishme përkatësisht aktvendimeve për kundërvajtjet, të cilat në Republikën e Sllovenisë i mbanë Ministria e drejtësisë;
- nga evidencat për vendimet e plotfuqishme të kundërvajtjeve, të cilat i mbajnë organet për kundërvajtje në Republikën e Sllovenisë;
- mbi aktakuzat e plotfuqishme të depozituara dhe aktgjykimet e jo plotfuqishme të lëshuara, të cilat i mbanë gjykata kompetente;
- nga evidencat, të cilat i mban organi tatimor mbi detyrimet tatimore të jopaguara të skaduara dhe mbi kundërvajtjet tatimore, të cilat janë të shënuara si sekret tatimor.

**C – Lutjes për lëshimin ose vazhdimin e lejes unike për personin, i cili është i rivendosur brenda shoqërisë ekonomike si i punësuar në aftësim (neni 21. dhe 23. i Ligjit për punësim, vetëpunësim dhe punë të huajve) duhet bashkëlidhur:**

- fotografinë e të huajit ose numrin referues nga deponimi elektronik i fotografive;
- pasaportën ose fotokopjen e verifikuar të pasaportës së të huajit;
- dëshminë për sigurimin shëndetësor adekuat, i cili mbulon së paku shërbimet shëndetësore emergjente në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji thekson, se në Republikën e Sllovenisë nuk posedon sigurimin e detyrueshëm shëndetësor;
- vërtetimin nga evidenca penale të shtetit amë të huajit, gjithmonë në rastin e lutjes për lëshimin e lejes së parë, kurse në rastet tjera, nëse organi kështu kërkon;
- dëshminë lidhur me këtë, se subjekti mikpritës i përket shoqërisë së lidhur;
- kontratën për punësim dhe aktin e dërgimit;
- dëshminë, se në shoqërinë e lidhur është i punësuar së paku 6 muaj, në rastin e rivendosjes së parë nga shteti, i cili nuk është anëtar i Unionit evropian;
- dëshminë mbi arsimimin e lartë;
- programin e aftësimin, kur organi kompetent kështu kërkon (paragrafi i pestë i nenit 23. i Ligjit për punësim, vetëpunësim dhe punë të huajve).

**Në procedurën e lëshimit të lejes unike njësia administrative dhe Enti i Republikës së Sllovenisë për punësim sipas detyrës zyrtare do ti sigurojnë të dhënat në vijim:**

- mbi sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji me rastin e dëshmimit të sigurimit shëndetësor thekson, se në Republikën e Sllovenisë ka sigurimin e detyruar shëndetësor;
- nga evidenca penale, evidenca e aktgjyqimeve të plotfuqishme përkatësisht aktvendimeve për kundërvajtjet, të cilat në Republikën e Sllovenisë i mbanë Ministria e drejtësisë;
- nga evidencat për vendimet e plotfuqishme të kundërvajtjeve, të cilat i mbajnë organet për kundërvajtje në Republikën e Sllovenisë;
- mbi aktakuzat e plotfuqishme të depozituara dhe aktgjykimet e jo plotfuqishme të

- lëshuara, të cilat i mbanë gjykata kompetente;
- nga evidencat, të cilat i mban organi tatimor mbi detyrimet tatimore të jopaguara të skaduara dhe mbi kundërvajtjet tatimore, të cilat janë të shënuara si sekret tatimor.

**Informata lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale:**

- të dhënat personale nga formulari për qëllim të lëshimit të lejes për qëndrim përpunohen në ujdi me nenin 93. të Ligjit për të huajt;
- organi ka të drejtë që të përfitoi edhe të dhëna tjera, nëse kjo është në interesin tuaj dhe se për këtë e keni dhënë pëlqimin ose nëse kjo është e lejuar me ligj, pëlqimin mund ta revokoni kurdoherë pranë organit;
- nëse për këtë janë plotësuar kushtet e parashkruara, keni të drejtë ndaj informimit me të dhënat tuaja personale, të drejtën ndaj përkufizimit të përpunimit dhe të drejtën ndaj kundërshtimit të përpunimit;
- keni të drejtë që të verifikoni saktësinë e të dhënave tuaja personale, të shënuara në lejen për qëndrim, dhe të drejtën që të kërkonti ndryshimin e tyre ose, nëse për këtë janë të plotësuar kushtet e parashkruara, fshirjen e tyre;
- menaxhuesi i ruan të dhënat tuaja në ujdi me nenin 115. të Ligjit për të huajt;
- kontakti i personit të autorizuar të menaxhuesit për mbrojtjen e të dhënave personale në Ministrinë e punëve të brendshme: posta elektronike: [dpo.mnz@gov.si](mailto:dpo.mnz@gov.si);
- nëse jeni të mendimit, se të dhënat tuaja po përpunohen joligjshëm, mund të ushtroni ankesë pranë Autorizuesit të informimit.